



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1159 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2021

VENDIM PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KKTKM

Nr. 448, datë 28.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndryshuar, Pika V, 1 për rinovimin e licencave në fushën e Trashëgimisë Kulturore, si dhe pikës 3 të nenit 113, të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pas shqyrtimit më parë nga Këshilli Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.07.2021:

VENDOSI:

1. Saktësimin dhe ndryshimin e vendimeve si më poshtë vijon:
 - a) Në vendimin nr. 112 datë 01.03.2021 të KKTKM-së të saktësohet emri i subjektit sipas QKB-së, Comfort-96 Sh.p.k..
 - b) Në vendimin nr.113 datë 01.03.2021 të KKTKM-së të saktësohet emri i subjektit sipas QKB-së, “J O G I Sh.p.k. si dhe të saktësohet emri i drejtuesit teknik në Pellajia.
 - c) Në vendimin nr. 140 datë 12.03.2021 të KKTKM-së të shtohet Nr. i licencës ekzistuese RSH 20 dhe të saktësohet emri i drejtuesit teknik Skënder Bejko.
 - d) Në vendimin nr. 202 datë 06.04.2021 të KKTKM-së të saktësohen nënkategoritë e përfituara nga konvertimi të cilat janë NPA2- NPA7 dhe nga NZA2- NZA7, të saktësohet mbiemri i drejtuesit teknik në Biçoku.
 - e) Në vendimin nr. 151 datë 19.03.2021 të KKTKM-së të saktësohen nënkategoritë e përfituara nga konvertimi të cilat janë nga NZA2- NZA7.
 - f) Në vendimin nr. 187 datë 29.03.2021 të KKTKM-së të ndryshohet kategoria nga “Projektim” në “Zbatim”.
 - g) Në vendimin nr. 116 datë 01.03.2021 të KKTKM-së të hiqet nr. 16 i licencës pasi nuk rezulton si dokument në dosje të saktësohet mbiemri i drejtuesit teknik “Muçaj”.
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Llva MARGARITI